



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:012465

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05510885

C.nr.153/20

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Agron Karatash, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.R. nga fshati Komuna e Suharekës, të cilën me autorizim e përfaqëson av. N.H. nga Suhareka, kundër të paditurit N.P.N “Q.....”, me seli në fshatin Korishë, Komuna e Prizrenit, për shkak të moskryerjes së obligimeve sipas kontratës për shitblerje të lokalit afarist në ndërtim, me datën 27.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. DETYROHET i padituri, N.P.N “Q.....”, me seli në fshatin Korishë, Komuna e Prizrenit, që në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i padisë me të gjitha shkresat, të cilat i janë bashkangjitur këtij aktvendimi t’i paraqes gjykatës përgjigje në padi në formë të shkruar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën paditëse, nën kërcënim të pasojave procedurale.

II. I padituri është i detyruar që në përgjigjen në padi t’i paraqes prapësimet procedurale dhe të deklarohet se e pranon apo e konteston kërkesëpadinë e paditëses. Në qoftë se i padituri e konteston kërkesëpadinë e paditëses, përgjigja në padi duhet ti përmbaj faktet mbi të cilat i padituri i bazon thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e paraqitura. Përgjigja në padi duhet të përmbaj të gjitha elementet e parapara me dispozitat e nenit 99 të LPK-së.

III. Në qoftë se, përgjigja në padi është e pakuptueshme apo jo e plotë me qëllim të eliminimit të këtyre të metave, gjykata do të veproj në pajtim me dispozitat e nenit 102 të LPK-së.

IV. Personi i cili paraqitet si përfaqësues ligjor është i detyruar që me rastin e ndërmarrjes së veprimit të parë procedural të provon cilësinë e përfaqësuesit ligjor, ndërsa i autorizuari me ndërmarrjen e veprimit të parë procedural është i detyruar që gjykatës t’ia paraqes autorizimin e rregullt.

A r s y e t i m

Paditësja E.R. nga fshati Komuna e Suharekës, të cilën me autorizim e përfaqëson av. N.H. nga Suhareka, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurit N.P.N “Q.....”, me seli në fshatin Korishë, Komuna e Prizrenit, për shkak të moskryerjes së obligimeve sipas kontratës për shitblerje të lokalit afarist në ndërtim.

Numri i lëndës: 2020:012465
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05510885

Me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme ligjore lidhur me këtë çështje kontestimore, gjykata ka bërë shqyrtimin paraprak të padisë dhe në kuptim të nenit 387 par. 1 pika a, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për të ja dërguar palës së paditur aktvendimin për përgjigje në padi.

Andaj, gjykatësi i çështjes në pajtim me dispozitat e nenit 77, 93 par. 1, 99, 102, 387 par. 1 pika (a), 394, 395, 396 dhe 397 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:012465, 27.03.2024

Gjyqtari
Agron Karatash

KËSHILLË JURIDIKE: Duke u bazuar në nenin 387 par. 2 të LPK-së, kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.